

RREGULLORJA
MBI PROCEDURËN E VETËVLERËSIMIT DHE VLERËSIMIT TË KOLEGJIT ESLG

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

(Qëllimi)

(1) Rregullorja rregullon rregullat për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e Kolegjit.

Neni 2

(Forma e ekipit të vetëvlerësimit)

(1) Pas propozimit të rektorit të Kolegjit, Senati emëron anëtarët e ekipit të vetëvlerësimit. Ekipi i vetëvlerësimit përbëhet nga tre deri në pesë anëtarë.

Neni 3

(Përkufizimi i objektivave të vetëvlerësimit)

- (1) Vetëvlerësimi është hapi i parë në procesin e vlerësimit dhe është hapi themelor në zbatimin e procesit të vlerësimit të brendshëm.
- (2) Fushëveprimi i vetëvlerësimit të aktiviteteve arsimore dhe hulumtuese është mbajtja, avansimi, dhe përmirësimi i cilësisë së punës arsimoro-edukative. Vetëvlerësimi kryhet në nivel institucional dhe ofron bazë të arsyeshme për vendim-marrje dhe planifikim të zhvillimit profesional dhe ofron bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
- (3) Vetëvlerësimi kryhet në të gjitha nivelet, kryesisht në nivel të programit të studimit dhe hulumtimit në kuadër të secilës njësi organizative të institucionit. Në praktikë kryhet një kombinim i vetëvlerësimit të kryer në të gjitha nivelet.
- (4) Në proces të sigurimit të arsimit cilësor, vetëvlerësimi përqëndrohet në aktivitetin arsimor, hulumtues apo profesional (vetëvlerësimi i programit). Cikli i vetëvlerësimit përfundon kur vetëvlerësimi i programit pasohet nga vetëvlerësimi në nivel institucional.

Neni 4

(Përgatitja e planit të vetëvlerësimit)

- (1) Pas emërimit të ekipit të vetëvlerësimit, ky i fundit përpilon një plan të vetëvlerësimit.
- (2) Plani i vetëvlerësimit përbëhet nga elementet në vijim:

- qëllimi i vetëvlerësimit,
- kufizimet e vetëvlerësimit,
- pasqyrë e aspekteve kryesore të cilat do të mbulojnë vetëvlerësimin,
- kriteret,
- informatat e nevojshme,
- orari kohor
- dhe detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit.

Neni 5 (Masat e vetëvlerësimit)

- (1) Gjatë vetëvlerësimit të kolegjit çështjet si në vijim do të jenë objekt i vlerësimit:
- Qëllimi, politikat, objektivat, strategjia, organizimi dhe menaxhimi i Kolegjit dhe shqetësimet e cilësisë,
 - Arsimimi – programi i studimit dhe aktiviteti i studimit- Hulumtimi shkencor, artistik dhe aktivitetet profesionale,
 - Staf i akademik, stafi hulumtues dhe stafi tjetër,- Punëtorët administrativ, teknik dhe profesional,
 - Studentët- Lokalet, pajisjet, arsimimi, hulumtimi shkencor dhe aktivitetet profesionale,
 - Financimi i arsimimit – programi i studimit, aktiviteti hulumtues dhe aktivitetet tjera artistike dhe profesionale
 - Bashkëpunimi me shoqërinë në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 6 (Mbledhja e informatave gjatë përgatitjes së dokumentacionit)

- (1) Gjatë procesit të vetëvlerësimit është e nevojshme të mbledhen informatat e caktuara që ndërlidhen me fushëveprimin dhe objektivat e vetëvlerësimit. Informatat mund të jenë kuantitative dhe kualitative dhe si të tilla të dyjat janë njëloj të rëndësishme dhe secila prej tyre duhet të specifikojnë burimet individuale.
- (2) Me qëllim të kryerjes së vetëvlerësimit, mbledhja e informatave relevante është me rëndësi kyçe për shkak se nëpërmjet të saj gjetjet e vetëvlerësimit mund të identifikohen në mënyrë adekuate.
- (3) Para se të mbledhet ekipi i vetëvlerësimit për mbledhjen e informatave relevante, kriteret të cilat janë të nevojshme për udhërrëfimin e një sistemi të vlerësimit duhet të përcaktohen. Ekipi i vetëvlerësimit duhet të konsiderojë informatat të cilat janë të shoqëruara me kriteret të

cilat do të mbështesin gjetjet e vetëvlerësimit.

- (4) Pasi informatat e mbledhura të kenë përmbushur kriteret, ato bëhen dokumentacion për vetëvlerësim. Informatat duhet të jenë të qasshme, relevante, të sakta, të qëndrueshme dhe valide.

Neni 7

(Analiza e materialit të mbledhur dhe dizajni i sistemit të vlerësimit)

- (1) Pas mbledhjes së informatave dhe formimit të informatave, pason interpretimi i tyre.
- (2) Procesi i vetëvlerësimit përfundon me një vlerësim të fuqive dhe dobësive të aspekteve individuale të përmirësimit të cilësisë dhe sigurimit të cilësisë. Ekipi i vetëvlerësimit shqyrton të gjitha faktet dhe bën një vlerësim të gjendjes dhe përmirësimit të cilësisë. Ekipi i vetëvlerësimit konsideron faktet, bën një vlerësim të gjendjes dhe përgatit propozimet për masat e mundshme të kontrollit të cilësisë dhe përmirësimit të të metave.

Neni 8

(Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit)

- (1) Raporti me shkrim i vetëvlerësimit është rezultati kryesor i procesit të vetëvlerësimit. Raporti i vetëvlerësimit përfshin një vlerësim dhe analizë kritike, analizë SWOT dhe ofron rekomandime dhe propozime për masat korrigjuese dhe përmirësimin e cilësisë.
- (2) Raporti i vetëvlerësimit duhet të përmbush kërkesat e madhësisë, strukturës, përmbajtjes, orarit kohor dhe autorësisë.
- (3) Përfundimet e raportit të vetëvlerësimit duhet të përfshijnë vlerësimet të cilat mbështeten me dokumentacionin dhe rekomandimet për përmirësim të mëtutjeshëm të cilësisë. Rekomandimet duhet të jenë të qarta dhe të realizueshme dhe duhet t'ju adresohen në mënyrë të qartë atyre individëve të cilët janë përgjegjës për përmirësimin e cilësisë.
- (4) Raporti i vetëvlerësimit duhet të promovojë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, menaxhimin efikas dhe administratën, përgatitjen e brendshme për vlerësimin e jashtëm dhe duhet të ofrojë informata për ekspertët e jashtëm.
- (5) Ekipi i vetëvlerësimit përgatit raportin e vetëvlerësimit çdo vit. Ekipi i vetëvlerësimit i'a dërgon raportin senatit, këshillit të studentëve dhe kuvendit akademik.

Neni 9

(Monitorimi dhe sistemi i përmirësimit të cilësisë)

- (1) Krahas përshkrimit dhe analizës kritike të aspekteve kryesore të sistemit të cilësisë, raporti i vetëvlerësimit duhet gjithashtu të përfshijë metodat, procedurat dhe masat për përmirësimin e

sistemit të cilësisë dhe korrigjimin e të metave të cekura.

- (2) Në përfundim, ekipi i vetëvlerësimit formulon në mënyrë të qartë rekomandimet për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së bazuar në fuqitë dhe dobësitë e identifikuara. Bazuar në rezultatet e raportit të vetëvlerësimit, Kolegji përgatit një plan strategjik për përmirësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në të ardhmen.
- (3) Pas procesit të vetëvlerësimit, plani i aktiviteteve të ardhshme të universitetit duhet të dizajnohet i cili ngërthen në veti proceset vendim-marrëse për veprim të mëtutjeshëm dhe procedurat për përmirësimin e sistemit të cilësisë.
- (4) Është e nevojshme që të themelohet një sistem i qartë i monitorimit dhe verifikimit të rregullt të implementimit të veprimeve të rekomanduara dhe identifikimit të efekteve të tyre. Është e domosdoshme të themelohet një sistem i raportimit të informatave ashtuqë anëtarët e ekipit të vetëvlerësimit dhe palët tjera të interesuara të cilat kanë marrë pjesë në procesin e vetëvlerësimit të jenë në gjendje të fitojnë njohuri për rezultatet e përmirësimit të sistemit të sigurimit të cilësisë, i cili ka buruar nga vetëvlerësimi. Këto rezultate raportohen në vetëvlerësimin e ardhshëm të institucionit.

Neni 10

(Vetëvlerësimi i programeve të studimit)

- (1) Komisioni përkatës në kuadër të Kolegjit monitoron implementimin e planprogramit dhe aktiviteteve profesionale sipas nevojës. Vetëvlerësimi i programit kryhet para implementimit të ndryshimeve kyçe në program. Në këtë vetëvlerësim kriteret e caktuara për monitorimin, vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë për institucione do të vlejnjë edhe për programet e studimit dhe të hulumtimit, punën artistike dhe profesionale me disa përshtatje të vogla.

Neni 11

(Vetëvlerësimi institucional)

- (1) Kolegji kryen një vetëvlerësim të gjerë të të gjitha aktiviteteve të gjithëmbarshme (vetëvlerësimi institucional) çdo pesë deri në shtatë vjet.
- (2) Është e dëshirueshme që vetëvlerësimi i kolegjit të plotësohet edhe nga vlerësimi i jashtëm dhe në një fazë të mëvonshme edhe nga një vlerësim shtesë »follow-up«.

Neni 12

(Mbrojtja e shënimeve)

- (1) Gjatë kryerjes së detyrave të veta komisioni duhet të respektojë konfidencialitetin e informatave, sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajë konfidencialitetin e informatave të biznesit në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

PROCESI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i vlerësimit të jashtëm është përmirësimi i efekteve pozitive të vetë-vlerësimit. Avantazhi i vlerësimit të jashtëm është angazhimi i ekspertëve më të kualifikuar dhe të pavarur për vlerësim.

Neni 13

(Fillimi i procedurës)

- (1) Procesi i vetëvlerësimit të jashtëm fillon pas propozimit të Senatit të Kolegjit.

Neni 14

(Përzgjedhja e vlerësuesves)

- (1) Kolegji zgjedh vlerësuesin e jashtëm. Agjencia Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë, ndonjë agjenci ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë apo vetë institucioni mund të kryejnë vlerësimin e jashtëm, i cili mund të njihet gjithashtu edhe nga rrjeti i jashtëm i agjencive të sigurimit të cilësisë të arsimit të lartë. Kontraktori i jashtëm i vlerësimit është i caktuar për secilin vlerësim.

Neni 15

(Roli)

- (1) Roli i Kolegjit në fillimin e procesit të vlerësimit është të mbledh çështjet si në vijim:

- Detajet e aplikimit (përshkrimi i statusit juridik, organizimi, emri i përfaqësuesit juridik),
- Arsyetimi i shkurtër i aplikimit

- (2) Kërkesa e vlerësimit të jashtëm parashtrohet brenda afatit kohor. Kolegji mëpastaj emëron komisionin e vlerësimit të jashtëm.

Neni 16

(Komisioni për vlerësim të jashtëm)

- (1) Komisioni për vlerësim të jashtëm përfaqëson një grup të ekspertëve të ftuar nga Kolegji për të ndërmarrë një vlerësim të jashtëm. Komisioni për vlerësim të jashtëm përbëhet nga

ekspertët e pavarur nga bota akademike dhe profesionale.

- (2) Pas pranimit dhe analizës së dokumentacionit relevant nga Kolegji, Komisioni për Vlerësim të Jashtëm përcakton një afat kohor për vizitën vlerësuese.

Neni 17 (Dokumentacioni)

(1) Dokumentacioni i kërkuar nga Komisioni për Vlerësim të Jashtëm mundet, ndërmjet tjerash të jetë ëshë ai si në vijim:

- Plani vjetor të punës së universitetit,
- raporti vjetor të universitetit,- raporti i vetëvlerësimit të universitetit, i cili duhet të reflektojë monitorimin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë si dhe mjetet për korrigjimin e të metave në sistemin e sigurimit të cilësisë - Anketa e studentit për tre vitet e fundit para fillimit të procesit të vlerësimit, përfshirë edhe vitin akademik për të cilin procesi i vlerësimit është duke u zhvilluar,
- Rregullat e monitorimit, identifikimit dhe sigurimit të cilësisë së universitetit,
- Misioni dhe vizioni i Kolegjit
- Plani strategjik i kolegjit- Dokumentet tjera sipas nevojës të cilat kërkohen nga komisioni për vlerësim të jashtëm me qëllim të implementimit të vlerësimit të jashtëm.

Neni 18 (Vizita në vendin e ngjarjes e komisionit për vlerësim të jashtëm)

- (1) Gjatë vizitës në vendin e ngjarjes komisioni për vlerësim të jashtëm zhvillon biseda me stafin mësimdhënës dhe atë jomësimdhënës të universitetit.
- (2) Gjatë vizitës në vendin e ngjarjes kolegji ofron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për komisionin e vlerësimit të jashtëm, të cilin komisioni e sheh si të nevojshëm për kryerjen e vlerësimit. Komisioni për vlerësim të jashtëm ka qasje në të gjithë të punësuarit për të adresuar proceset specifike të vendosura nga kolegji.
- (3) Shpenzimet e vizitës në vendin e ngjarjes nga komisioni i vlerësimit mbulohen nga kolegji dhe janë të përfshira në buxhetin e kolegjit.

Neni 19 (Raporti i komisionit të vetëvlerësimit)

- (1) Komisioni i vlerësimit të jashtëm harton një raport të vlerësimit brenda afatit të përcaktuar kohor. Raporti i parë i drejtohet rektorit të kolegjit, i cili ka mundësi t'a shqyrtojë dhe sqarojë ndonjë pjesë të keqkuptuar dhe brenda afatit të rënë dakord ai/ajo ka mundësi të jep komentet e tij / saj.
- (2) Komisioni i vlerësimit të jashtëm i'a përcjell raportin e vlerësimit me komente Kolegjit.
- (3) Kolegji duhet të informojë të gjithë të punësuarit në lidhje me përfundimet e komisionit për vlerësim të jashtëm.

Neni 20

(Plani i përmirësimit të cilësisë)

- (1) Kryesuesi i çdo njësie të Kolegjit themelon një komision implementues, i cili do të paraqes pikëpamjet e njësisë përkatëse në diskutimet e mëvonshme përcjellëse.
- (2) Komisioni implementues është përgjegjës për hartimin e planit për përmirësimin e cilësisë bazuar në Raportin e vetëvlerësimit dhe raportit të ekipit vlerësues.
- (3) Plani për përmirësimin e cilësisë përfshin:
 - (i). Listën e qëllimeve të cilat mund të arrihen në mënyrë realiste brenda vitit të ardhshëm.
 - (ii). Listën e qëllimeve afatgjate që duhet arritur brenda pesë viteve.
 - (iii). Vlerësimet e qëllimeve afatgjatë të cilët duhet arritur brenda pesë viteve.

Neni 21

(Financimi për përmirësimin e cilësisë)

- (1) Kolegji themelon fondin për përmirësimin e cilësisë brenda dy viteve.
- (2) Kolegji themelon komisionin financiar për përmirësimin e cilësisë.
- (3) Kolegji gjithashtu themelon një nënkomision të përhershëm akademik për cilësi i cili do të përpilojë listën e kërkesave të cilat duhet të përfshihen në planet e përmirësimit të cilësisë.
- (4) Fondi për përmirësimin e cilësisë do të financohet 50 % nga granti dhe 50 % nga buxheti i Universitetit.

Neni 22

(Follow-up)

- (1) Pesë vjet pasi që Kolegji apo njësia e Kolegjit të ketë kryer sigurimin e

cilësisë/rishikimin e përmirësimit të cilësisë, Menaxheri për Sigurim të Cilësisë do të themelojë një komision të vogël të përbërë nga Menaxheri për Sigurim të Cilësisë (apo i caktuari i tij/saj), dekani i njësisë dhe një anëtar i Komisionit të Përhershëm për Përmirësimin e Cilësisë.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 23

(Rregullat e pranimit)

- (1) Bordi Menaxhues i Kolegjit miraton rregulloren në fjalë.
- (2) Ndryshimi i kësaj rregullore duhet të ndjek të njëjtën procedurë sikurse që është përdorur për miratimin e vet rregullores.

1. Procedurat për rishikimin e programeve të studimit

Rishikimi i programeve të studimit në kuadër të Kolegjit bëhet duke marrë parasysh misionin dhe vizionin e Kolegji, filozofinë arsimore të Kolegjit, politikat arsimore në nivel të Kosovës dhe rajonit por edhe mjedisin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe rajonit.

Njësitë akademike të Kolegjit (departamentet dhe fakultetet) kanë një rol parësor në procesin e rishikimit të programeve të studimit.

Zyra e Dekanit të fakultetit apo shefit të njësisë akademike rekomandon rishikimin e programit të studimit Këshillit Akademik për miratim.

Pas miratimit të propozimit nga Këshilli Akademik, njësitë akademike punojnë në rishikimin e kurrikulës së programit të studimit dhe atë ja dorëzojnë së bashku me arsyeshmërinë dhe planin e biznesit dhe të implementimit Bordit Menaxhues të Kolegjit ESLG për miratim.

Rishikimi i programeve të studimit bëhet nga këto aspekte:

- a. mësimdhënia, mësimnxënia, përmbajtja e kurrikulës;
- b. Progresin e studentëve sipas notës mesatare, punësimin të studentëve pas diplomimit, vijueshmërisë në procesin mësimor, numrit të studentëve të cilët e lëshojnë programin, tranzicionin prej një viti në tjetrin dhe përqindjen e diplomimit brenda afatit.
- c. Rishikon cilësinë e personelit akademik i cili implementon programin e studimeve duke matur përqindjen e stafit me doktorata dhe tituj akademik.
- d. Rishikon në formë gjithëpërfshirëse si vetëvlerësim programin çdo tre vjet.

- e. Vlerëson performansën e të diplomuarve në tregun e punës pas diplomimit duke zhvilluar anketa çdo pesë vjet me të diplomuarit për të kuptuar destinacionin e tyre të karrierës.

Paraqitja e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë së programit/ kursit

ESLG-ja përdor pyetësorët si instrumente të vlerësimit. Është shumë e rëndësishme që të merren pikëpamjet e studentëve, stafit, të diplomuarve, dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve të ESLG-së.

Sa i përket departamentit akademik apo fakultetit parashikohet që pyetësori të plotësohet për çdo modul të ligjëruar. Pyetësorët duhet të aplikohen edhe për ushtrime, vizita studimore etj. Sugjerohet që pyetësorët e studentëve të administrohen pas përfundimit të semestrit dimëror apo atij veror.

Gjithashtu përdoren edhe fokus grupe të studentëve të përzgjedhur me të cilët testohen format dhe metodat e ndryshme të mësimdhënies, ngarkesa e orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve, literatura përkatëse etj. Grupi fokus i nënshtrohet disa testeve të caktuara të formave të ndryshme të mësimdhënies dhe ngarkesave me orë të ligjërata, literaturë dhe detyra në kuadër të lëndës si pjesë e notimit dhe në bazë të përqindjes së arritjes së rezultateve të deklaruara të mësimdhënies në planprogramin e lëndës të grupit fokus, vendoset se çfarë metodologjie e mësimdhënies të ofrohet. Grupet fokus gjithashtu filmohen dhe reagimet e tyre ndaj formave të ndryshme të mësimdhënies dhe formave të ndryshme të vlerësimit shqyrtohen me kujdes nga Zyra për Cilësi.

Mekanizmat për implementimin e masave për sigurimin e cilësisë

Mekanizmat për implementimin e masave për sigurimin e cilësisë janë:

- a) Plani për zhvillimin e stafit akademik të programeve studimore;
- b) Procesi i miratimit të programeve studimore bëhet pas konsideratave të plota të realizuara në nivel të departamentit, fakultetit apo kolegjit të të gjitha mundësive mësimore që programet e reja të propozuara mund të ofrojnë;
- c) Politikat dhe procedurat për rishikimin vjetor të programeve studimore të ofruara që bazohen në të dhëna kuantitative dhe kualitative për cilësinë e ofrimit të këtyre programeve studimore ;
- d) Procesi i rishikimit periodik të secilit departament;
- e) Përfshirja e studentëve në të gjitha proceset e sigurimit të cilësisë së Kolegjit nëpërmjet të pyetësorëve për vlerësim, përfshirjes së studentëve në rishikimet periodike të

departamenteve dhe fakulteteve të kolegjit, përfshirjes së studentëve në komitetet e ndryshme në nivel të departamentit, fakultetit dhe kolegjit në përgjithësi;

- f) Procesi rigoroz i miratimit të lëndëve të reja në kuadër të programit studimor;
- g) Paneli ekzaminues i cili rishikon notimin nga ana e profesorëve i cili siguron që studentët janë të notuar në mënyrë fer dhe në bazë të Rregullores për Vlerësimin e Studentëve të Kolegjit;
- h) Rishikimi i rregullt i brendshëm i lëndës për të monitoruar implementimin e cilësisë së lëndëve të dhëna secilin semestër;
- i) Rishikimi gjithëpërfshirës i programeve studimore me inpute nga ana e ekspertëve të jashtëm;

Procedurat vijuese për përmirësim (follow up)

Aktivitetet shtesë pas vetëvlerësimit janë një pjesë përbërëse e procesit. Vendimet për përmirësim, të cilat merren pas vetëvlerësimit dhe rishikimit ofrojnë një kornizë në kuadër të të cilit ESLG-ja apo njësia e ESLG-së mund të vazhdojnë drejt realizimit të qëllimeve të zhvillimit dhe nxitjes së kulturës së menaxhimit të cilësisë në kuadër të ESLG-së.

Sistemi i sigurimit të cilësisë u ofron studentëve një mundësi për të marrë pjesë dhe ndikuar në zhvillimin e arsimimit të tyre. Duke marrë pjesë në ekipet për cilësinë e programeve studentët të fitojnë një kuptim më të thellë të sigurimit të cilësisë dhe operacionet e vlerësimit të cilësisë.

Studentët janë të ftuar të marrin pjesë në faza të ndryshme të procesit të rishikimit të cilësisë: përfaqësuesit e tyre janë të ftuar për të bërë një paraqitje me shkrim për të informuar ekipin e sigurimit të cilësisë dhe takimet me nxënësit janë të rregulluara gjatë vizitave të informimit dhe të kontrollit për të siguruar që ata kanë mundësinë për të ngritur në kuadër të grupit. (Rregullorja e brendshme e Menaxhimit të Cilësisë, ESLG).

Përfaqësimit i studentëve është thelbësor për të siguruar një sigurim të duhur të cilësisë. Rregullat tona të Menaxhimit të Cilësisë ofrojnë disa praktika të mira, megjithatë, Bordi ka shqyrtuar disa praktika të mira që duhet të përshtaten me nevojat e Kosovës. Ato janë si më poshtë:

- Përfshirja e studentëve në punën e Komitetit të Pranimit të Kolegjit në të gjitha programet (kjo praktikë tashmë implementohet në kuadër të Shkollës së Biznesit në Londër);
- Përfshirja e përfaqësuesve të studentëve në marrëveshjet e menaxhimit të cilësisë në nivel institucional;
- Krijimi i Komitetit Këshilldhënës Staf Student të Kolegjit, i cili siguron përfaqësimin dhe konsultimin e nxënësve në nivel lënde (kursi);

- Krijimi i paneleve shqyrtuese të lëndëve dhe anëtarësimi i studentëve në panelet shqyrtuese të lëndëve;
- Vlerësimi i lëndës dhe arranzhimet raportuese të studentëve të rezultateve;
- Takimet mujore të Përfaqësuesve të Studentëve me Presidentin, Menaxherin e Cilësisë dhe Zëvendës-Dekanin për Çështjet Studentore;
- Përfshirja e përfaqësuesve të studentëve në hartimin e politikës së emërimit të personelit akademik.
- Krijimi i komisioneve të ndërlidhjes staf student;
- Publikimi i Librit Udhëzues të përfaqësimit të studentëve për përfaqësuesit e studentëve;

Sa i përket shkelësve të cilësisë Komiteti për Çështje Akademike do të shqyrtojë dhe analizojë vlerësimin e studentëve të kurseve dhe profesorëve dhe do të vendos procedurat e nevojshme për t'u marrë me shkelësit e cilësisë. Megjithatë, anketat tregojnë se notat të cilat i pranojnë instruktorët kanë korelacion pozitiv me performansën e studentëve të tyre në provimin përfundimtar. Ne duhet të arrijmë një ekuilibër ndërmjet të ndërmarrjes së veprimeve disiplinore ndaj shkelësve të cilësisë dhe analizave efektive të vlerësimit të studentëve.

Në mënyrë për të shmangur këtë tendencë të korrelacionit pozitiv të notave që pranojnë instruktorët nga studentët me rezultatin e studentëve në provimin përfundimtar, Kolegji do t'a bëjë të detyrueshme kryerjen e vlerësimeve mes-semestrale i cili u jep profesorëve një shans për t'u përmirësuar. Gjithashtu, vlerësimi i studentëve duhet të përfshijë pyetje specifike dhe jo pyetje të paqarta të tilla si Sa mirë të planifikuara ishin mësimet?

Vlerësimi i studentëve nga disa konsiderohet se pengon lirinë akademike. Ne mendojmë se vlerësimet e studentëve ndikojnë në një farë mase në politikën e notimit të instruktorëve, stilin e mësimdhënies, dhe sigurisht vështirësinë, por ato gjithashtu mund të kufizojnë atë çka një profesor thotë në klasë. Profesorët mund të ndjehen të frenuar nga diskutimi i ideve të diskutueshme ose sfiduese në besimet e nxënësve, për shkak të frikës se disa studentë do të shprehin kundërshtimin e tyre me formularin e vlerësimit të lëndës.

Plani për përmirësimin e cilësisë

Pas pranimit të raportit të vetëvlerësimit, kreu i ESLG-së apo njësisë së ESLG-së themelon një komision implementues i cili do të prezantojë pikëpamjet e njësisë përkatëse të ESLG-se në diskutimet e mëtejme që mbahen në vijim të vetëvlerësimit.

Përgjegjësia kyçe e komisionit implementues do të jetë hartimi i planit për përmirësimin e cilësisë bazuar në raportin e vetëvlerësimit dhe raportin e ekipit vlerësues.

Plani për përmirësimin e cilësisë do të përfshijë propozime të detajuara për implementimin e rekomandimeve të dalura nga raportet e vetëvlerësimit dhe raporti i ekipit vlerësues (shih Rregullën për Vetëvlerësim dhe Vlerësim) në çështjet si në vijim:

(i). çështjet organizative dhe administrative të ESLG-se.

(ii).Mangësitë në ofrimin e shërbimeve, procedurat dhe objektin e ESLG-se të cilat janë jashtë kontrollit të njësisë së ESLG-se.

(iii). Stafi, objekti dhe resurset tjera joadekuate të cilat kërkojnë kapital apo financim të vazhdueshëm:

Plani për përmirësimin e cilësisë do të përfshijë:

(i). listën e qëllimeve të cilat realisht mund të arriten në vitin e ardhshëm.

(ii).listën e qëllimeve afatgjate që duhet arritur brenda pesë viteve.

(iii).Projektimin e qëllimeve afatgjate që duhet arritur brenda pesë viteve.

Prishtinë, 20.08.2019

Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Kryetar i Bordit

